



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2018:024299

Datë: 06.05.2019

Numri i dokumentit: 00332677

P.nr.724/17

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Mentor Bajraktari, me procesmbajtësen Nushe Kadrija – sekretare juridike pranë kësaj gjykate, në lëndën penale kundër të akuzuarës V. B. nga fshati R., Komuna e Gjakovës, për shkak të veprës penale shmangia nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore nga neni 318 par.1 të KPRK-së, e akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë–Departamenti i Përgjithshëm, me numër PP/II.nr.1215/17, të datës 12.10.2017, gjatë mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datën 30.04.2019, në prezencën e Prokurorit të shtetit Anton Hasanaj, si dhe të akuzuarës, në të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, dhe me datën 06.05.2019 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

E akuzuara:

V. B., nga i ati R., e ëma N., e gjinisë K., data e lindjes . . . , në Gjakovë, tani me banim në fshatin R., Komuna e Gjakovës, me vendqëndrim në Zvicër, . . . , e martuar, nënë e 2 (dy) fëmijëve, ka të kryer shkollën mesme, punëtorë në Zvicër, e gjendjes së mesme ekonomike, shqiptare-shtetase i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R E

Sepse me datën 08.08.2017, në kohë të pa caktuar, e pandehura me qëllim që vetit apo personit tjetër ti mundësoj shmangien nga pagesa e tarifave doganore apo tarifave tjera ose detyrimeve doganore që paguhen me rastin e importimit apo eksportimit të mallrave në atë mënyrë që gjatë kontrollit të ushtruar nga Njësiti i trafikut të Drejtorisë Rajonale të Policisë në Gjakovë, të dokumenteve të automjetit të markës . . . me targa të regjistrimit . . . me numër të shasis . . . i cili automjet me datën 07.08.2017 ishte i përfshirë në një aksident trafiku me fatalitet të dyfishtë në fshatin R., Komuna e Gjakovës, është vërtetuar se e pandehura gjatë muajit gusht të vitit 2016 kur ishte kthyer nga Kosova në Zvicër, automjetin e kishte lënë në shtëpi, ndërsa targat e regjistrimit i kishte marrë me vete për ta ç' lajmëruar, me këtë veprim i është shmangur obligimit bazë nga pagesa e detyrueshme doganore, dhe më këtë ka dëmtuar buxhetin e Kosovës, e të dëmtuarës D. K.i ka shkaktuar dëme në vlerë prej 5,110.73 euro.

Me këto veprime ka kryer veprën penale shmangia nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore nga neni 318 par.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në kuptim të neneve 4, 7, 17 par.1, 41, 42, 49, 50, 51, 52, 73, 74 dhe nenit 318 par.1 të KPRK-së të akuzuarit ia shqipton:

D Ë N I M I N M E K U S H T

Duke ia vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 4 (katër) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse e akuzuara brenda afatit të verifikimit prej 1 (një) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale.

E dëmtuara D. K., me seli në Prishtinë, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

Detyrohet e akuzuara, që ti paguajë shpenzimet e paushallit gjyqësorë në shumën prej 50 (pesëdhjetë) Euro, ndërsa për programin për kompensimin e viktimave të krimin shumën prej 30 (tridhjetë) Euro, të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm, pranë kësaj gjykate ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.1215/17 të datës 12.10.2017, kundër të akuzuarës V. B. nga fshati R., Komuna e Gjakovës, për shkak të veprës penale shmangia nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore nga neni 318 par.1 të KPRK-së. Prokurori i shtetit Anton Hasanaj gjatë seancës së shqyrtimit fillestar, pas leximit të aktakuzës ka bërë përmirësimin e përshtimit faktik, duke deklaruar se në rreshtin e fundit ku është shënuar “e ka dëmtuar buxhetin e Kosovës” duhet ti shtohet “e të dëmtuarës D. K.i ka shkaktuar dëme në vlerë prej 5,110.73 Euro”, e po ashtu tek propozimi ti shtohet edhe fjalia “e dëmtuara D. K.me seli në Prishtinë”. Gjatë shqyrtimit fillestar Prokurori i shtetit, ka qëndruar në tërësi pranë aktakuzës kundër të akuzuarës V. B. andaj ka propozuar që e njëjta të shpallët fajtoreshë dhe të dënohet sipas ligjit.

E akuzuara V. B. nga Gjakova, gjatë shqyrtimit fillestar ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet dhe ka shtuar se ka qenë gabimi i jonë që nuk e kemi lajmëruar veturën në doganë, prandaj jam penduar për këtë veprim, dhe i premtoj gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsëris veprime të kësaj lloji.

Prokurori i shteti Anton Hasanaj, duke dhënë mendim rreth pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarës ka deklaruar se; nuk e kundërshtoj pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarës, pasi që e njëjta pranimin e fajësisë e bën me vetëdije dhe vullnet të plotë, pa presion, e njëjta e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, po ashtu pranimi i fajësisë mbështetet edhe në provat dhe në faktet që i janë bashkangjitur aktakuzës.

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Në tërësi u vërtetua se e akuzuara V. B., me datën 08.08.2017, në kohë të pa caktuar, e pandehura me qëllim që vetit apo personit tjetër ti mundësoj shmangien nga pagesa e tarifave doganore apo tarifave tjera ose detyrimeve doganore që paguhen me rastin e importimit apo eksportimit të mallrave në atë mënyrë që gjatë kontrollit të ushtruar nga Njësi i trafikut të Drejtorisë Rajonale të Policisë në Gjakovë, të dokumenteve të automjetit të markës . . . me targa të regjistrimit . . . me numër të shasis . . . i cili automjet me datën 07.08.2017 ishte i përfshirë në një aksident trafiku me fatalitet të dyfishtë në fshatin R., Komuna e Gjakovës,

është vërtetuar se e pandehura gjatë muajit gusht të vitit 2016 kur ishte kthyer nga Kosova në Zvicër, automjetin e kishte lënë në shtëpi, ndërsa targat e regjistrimit i kishte marrë me vete për ta ç' lajmëruar, me këtë veprim i është shmangur obligimit bazë nga pagesa e detyrueshme doganore, dhe më këtë ka dëmtuar buxhetin e Kosovës, e të dëmtuarës D. K.i ka shkaktuar dëme në vlerë prej 5,110.73 euro.

Gjykata gjendjen e këtyre faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga e akuzuara, e cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga e akuzuara është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-së. Gjatë pranimit të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatoi se e akuzuara ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga e akuzuara, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike dhe se nuk ekzistojnë asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 253 paragrafët 1 dhe 2 të KPP-së për hedhjen e aktakuzës përkatësisht pushimin e procedurës penale.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarës formohen të gjitha elementet e veprave penale shmangia nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore nga neni 318 par.1 të KPRK-së, dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarën të shpall fajtores dhe ta gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të saj.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarës gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 dhe 74 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarës se: është nënë e 2 (dy) fëmijëve, kujdese për 4 (katër) anëtarët e familjes, në gjykim ka patuar qëndrim tejet korrekt, pranimin e fajësisë në shqyrtimin fillestar, pendimin e saj dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra penale, faktin se e akuzuara më parë nuk ka qenë e dënuar, hera e parë që ndeshet me ligjin. Kështu që duke mos gjetur rrethana rënduese për të akuzuarën gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuara si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 41 dhe 50 i KPRK-së dhe këto dënime si të tillë të shqiptuara sipas bindjes së gjykatës janë në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon e akuzuara dhe se dënimi i shqiptuara do të ndikojnë në parandalimin e të akuzuarës nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjnë rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi mbi udhëzimin e palës së dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontest të rregullt juridiko- civil është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 463 par.2 të KPP-së.

Vendimi mbi shpenzimet e paushallit gjyqësor është marrë konform nenit 450 par.1 dhe 2 nën par. 2.6 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPP-së, ndërsa për programin për kompensimin e viktimave të krimit është marrë konform nenit 39 par.3 nënpar.3.1 të Ligjit Nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitivin të këtij aktgjykimi, konform nenit 365 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
- Departamenti i përgjithshëm -

P.nr.724/17, me datë 30.04.2019

**Procesmbajtësja,
Nushe Kadrija**

**Gjyqtari i vetëm gjykues,
Mentor Bajraktari**

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.